



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A
Zyrtari i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor

Nr. _____ Prot

Korçë më, 28.07.2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Drejtuar: "2 AT", adresa: Korçë- Dishnicë.

Procedura e prokurimit/lotit: "Procedurë e hapur e thjeshtuar" me mjete elektronike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-35674-07-07-2022

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Blerje paneli i pompave të dozimit të klorit dhe setit të injektimit të klorit, për Stacionin e Pompave Turan", me kohëzgjatje 20 ditë kalendarike, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 94 datë 12.07.2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "ALBUJI" Sh.p.k, NIPT: K64112206J, vlera: 980000 (nëntëqindetëdhjetëmijë) lekë pa TVSH.
2. "2 AT", NIPT: K14019001H, vlera: 1270000 (njëmilionedyqindeshtatëdhjetëmijë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. "ALBUJI" Sh.p.k

Emri i plotë i shoqërisë

NIPT: K64112206J

Numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

➤ Për operatorin ekonomik "Albuji" Sh.p.k, KVO vendosi në mënyrë unanime që, mbështetur në nenin 92 të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, si dhe në VKM nr.285

datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, nenin 88, pika 3, ky ofertues të mos kualifikohet sepse:

1. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pika 2.2.2 , Shtojca 7 e DT, që përcakton se: ” Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DT , shtojca 5 Specifikimet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogë teknike të cilët të tregojnë qartë skemën funksionale të pompave të dozimit të klorit si dhe skemën elektrike të këtyre pompave dhe që duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Te gjitha dokumentat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe ose të jenë të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe.” , për arsye se ofertuesi

- Ka paraqitur katalog teknik për një skemë funksionale të pompave të dozimit të klorit, por pa specifikuar tipin e pompave në këtë skemë, pra katalogu teknik i kësaj skeme i paraqitur nga operatori ekonomik nuk tregon se çfarë tipi pompe ofrohet .
- Duke mos zgjedhur tipin e pompës , operatori ekonomik nuk ka ofruar edhe skemën elektrike të pompave.

Pra operatori ekonomik nuk dëshmon teknikisht për çfarë tipi pompe oferton dhe çfarë skeme elektrike përshtat për sistemin tonë SCADA. OE nuk arrin të dëshmojë se mallrat e ofruara janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Gjithashtu KVO i ka dërguar "Albuji" Sh.p.k, nëpërmjet SPE , në datën 21.07.2022, Shkresën ”Kërkesë për sqarime lidhur me katalogun teknik të skemës funksionale të paraqitur ”, nëpërmjet së cilës, në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, Nenit 82 pika 2; Nenit 92 , pika 1; si dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar Nenit 26 , pika 7 ; Nenit 82, pika 1 dhe 2 i ka kërkuar sqarime lidhur me fragmentin e katalogut teknik të skemës funksionale të pompave të dozimit të klorit të paraqitur nga OE sepse tek kjo skemë funksionale nuk kuptohet se çfarë tipi pompe ofrohet.

KVO ka kërkuar që OE të sqaronte teknikisht se çfarë tipi pompe ofronte, karakteristikat teknike të saj (prurjen, presjonin, tensionin etj) dhe si përshtatet për sistemin elektrik SCADA të UKKO (skemën elektrike) .

"Albuji" Sh.p.k duhet t'i përgjigjej elektronikisht mesazhit të KVO , brenda datës 26.07.2022, ora 10.00, duke dhënë sqarime mbështetëse.

Rezulton që "Albuji" Sh.p.k nuk ka kthyer asnjë përgjigje.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ”2 AT”, adresa: Korçë- Dishnicë, se oferta e paraqitur, me vlerën totale 1270000 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Pandi Qirinxhi